

VENDIM
Nr. 676, datë 11.9.2026

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1058, DATË 16.7.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR DREJTORINË E
SHËRBIMEVE QEVERTARE”, TË NDRYSHUAR, DHE PËR DISA NDRYSHIME
NË DISA VENDIME TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”, të ndryshuar, shtohen pronat, sipas formularit të inventarizimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 16.1.2019, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të pasurisë me nr. 1/56, zona kadastrale 8150, Tiranë”, nr. 525, datë 7.9.2023, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik tek Ministria e Drejtësisë, të pasurive nr. 6/373-b2, nr. 6/373+2-1, nr. 6/373+2-2, nr. 6/373+2-3 e nr. 6/373+2-4, zona kadastrale 8350, Tiranë (pjesë e ish-hotel “Arbëria”)", nr. 217, datë 20.4.2018, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë tek Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të objektit ‘Godina e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë’”, nr. 227, datë 14.4.2021, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Kryeministrit të pronës me emërtimin ‘Godina e Kryeministrit’, ndodhur në zonën kadastrale 8160, dhe për shfuqizimin e vendimit nr. 968, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave”, nr. 494, datë 30.6.2005, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve të Jashtme”, të ndryshuar, nr. 165, datë 28.3.2007, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për nevojat e veta, të mjediseve, për ushtrimin e veprimtarisë së këtij institucioni”, të ndryshuar, shfuqizohen.

3. Pronat e përcaktuara në formularin e inventarizimit bashkëlidhur këtij vendimi hiqen nga listat e inventarit të miratuara me vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 250, datë 24.4.2003, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve të Brendshme”, të ndryshuar, nr. 232, datë 17.4.2024, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, nr. 717, datë 1.12.2017, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale”, të ndryshuar, nr. 820 datë 13.10.2010, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të institucioneve të varësisë, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, të ndryshuar, dhe nga sipërfaqja e truallit funksional e sipërfaqja ndërtimore e përcaktuar në vendimin nr. 471, datë 9.7.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të truallit, të ndërtesës së korpusit qendror

dhe sipërfaqes funksionale të tij, 'Ish-kinostudio', nga 'Alba Film', sh.a. tek Ministria e Kulturës, të ndryshuar, dhe në vendimin nr. 965, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes tek Ministria e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të pronës nr. 37, me emërtimin 'Ministria e Mbrojtjes', me vendndodhje në bulevardin 'Dëshmorët e Kombit', Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes', të ndryshuar".

4. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Institucioni Qendror Shtetëror: Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare												
Identifikoi pronën: Drejtor i Drejtorisë Administrative, DSHQ Anxhela Kostandini												
Supervizoi: Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Godinave Shtetërore, DSHQ Mihaela Çapi												
Aprovoi: Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare Dhurata Frashëri												
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip e pasurisë	Nga Sip.		Funksioni për të cilin përdoret pronat pasura	Institucioni në të cilin funksionon administrativisht pronës	Shërbimi që ndodhet në pasurisë Statusi juridik i përdorimit	Inventarizimi me MKM	Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
					(m2)	Tfuall (m2)	Ndertesë (m2)					
1	8150	4/830	Tfuall+ Ndertesë	Aparati Ministrise per Evropen dhe Punet e Jashtme	7620	7620	2401.4	Per Shërbime Qeveritare	DSHQ	MEPJ		
2	8150	1/56 1/64	Tfuall+ Ndertesë	Aparati Ministrise Infrastruktures dhe Energjise	693.9 386.9	693.9 386.9	693.9 264.3	Per Shërbime Qeveritare	DSHQ	MIE		
3	8150	1/59	Tfuall+ Ndertesë	Aparati Ministrise se Puneve te Brendshme	1800	1800	1231.8	Per Shërbime Qeveritare	DSHQ	MPB		
4	8380	6/506	Tfuall+ Ndertesë	Aparati Ministrise se Ekonomise dhe Inovacionit	3487.2	3487.2	495.7	Per Shërbime Qeveritare	DSHQ	MEI		
5	8380	6/505	Tfuall+ Ndertesë	Aparati Ministrise se Financave	5002	5002	2250	Per Shërbime Qeveritare	DSHQ	MF		
6	8350	6/373	Tfuall+ Ndertesë	Aparati Ministrise se Drejtise	1924.55	1924.55	1924.55	Per Shërbime Qeveritare	DSHQ	MD		6/373/ND+1-1....6/373/ND+1-7 6/373+2-1.....6/373+2-4 6/373-B2 6/373/ND-B1
7	8380	2/1	Tfuall+ Ndertesë	Aparati Ministrise se Arsimit	2307	2307	853	Per Shërbime Qeveritare	DSHQ	MA		
8	8380	5/223	Tfuall+ Ndertesë	Aparati Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	1095.62	1095.62	612.74	Per Shërbime Qeveritare	DSHQ	MSHMS		
9	8380	6/167	Tfuall+ Ndertesë	Aparati Ministrise se Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	1698	1698	1698	Per Shërbime Qeveritare	DSHQ	MBZHR		
Qeveritare												
10	8130	4/420	Tfuall+ Ndertesë	Aparati Ministrise se Turizmit, Kultures dhe Sportit	8007	8007	1610	Per Shërbime Qeveritare	DSHQ	MTKS		
11	8380	6/164	Tfuall+ Ndertesë	Aparati Ministrise se Mjedisit	912	912	863	Per Shërbime Qeveritare	DSHQ	MM		
12	8160	1/16	Tfuall+ Ndertesë	Kryeministria	12866.9	12866.9	3456.6	Per Shërbime Qeveritare	DSHQ	Kryeministria		
13	8380	2/99 2/100	Tfuall+ Ndertesë	MAPA	458 318	458 318	422 278	Per Shërbime Qeveritare	DSHQ	MAPA		